



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numrin 12-4015/1 datë 15.10.2021, për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, të dorëzuar nga parashtruesi-----, REFUZOHET

Pohimet në denoncim tregojnë për keqpërdorim të mjeteve buxhetore gjatë fushatës zgjedhore – automjeteve të MPB-së, por për faktin se nuk ka të dhëna të qarta, fotografi, vendndodhje, kohë të ngjarjeve, KSHPK nuk ka mekanizma për veprim të mëtutjeshëm.

Vendimi dhe denoncimi përkatës duhet të dorëzohen në procedurën kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RMV-së – Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve kriminale dhe Standardeve profesionale.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të njohur-----, me datë 15.10.2021, është dorëzuar denoncim me pohime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin ligjor – Zgjedhjet lokale 2021 dhe është formuar lëndë me numër 12 – 4015/1 nga 15.10.2021.

Në denoncim pohohet për keqpërdorim të mjeteve buxhetore gjatë kohës së fushatës zgjedhore në Zgjedhjet lokale 2021, gjegjësisht shfrytëzimin e automjeteve zyrtare të MPB-së – PS----- për nevojat e fushatës të partisë politike SDSM për shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Gjatë shqyrtimit të pohimeve në denoncim, KSHPK konstaton se në denoncimin e parashtruar nuk përmban informata konkrete: fotografi, tabela të regjistrimit, vendodhje, kohën e ngjarjes dhe të ngjashme, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndë, Për arsye të pohimeve serioze, denoncimi do të dërgohet në veprime kompetente në Ministrinë e punëve të brendshme të RMV-së - Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve kriminale dhe Standardeve profesionale.

Në bazë të lartpërmendurës, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР  
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
КРЈЕТАР,  
Biljana Ivanovska**

Dorëzuar deri te: Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

